

Komunat e Rajonit të Ferizajit

Profili Socio-Ekonomik

Ky botim është pjesë e programit të Konzortiumit të OJQ-ve (ATRC, KIPRED, BIRN, SPRC, KCBS dhe D+) “Me Demokraci Pjesëmarrëse për një Kosovë pa Radikalizëm”.

Consortium: "With Participatory Democracy for a Kosovo without Radicalization" | Konzorciumi: "Me Demokraci Pjesëmarrëse për një Kosovë pa Radikalizëm"



Përgatitur nga: Lulzim Peci, Mentor Agani, Diedon Nixha dhe Valdrin Ukshini.

Copyright © 2018, KIPRED. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk bën të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem rikthyes, apo të bartet, në çfarëdo qoftë forme dhe me çfarëdo qoftë pajisjesh, elektronike, mekanike, fotokopjuese, regjistruese, apo të tjera, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi. Luteni të kontaktoni: info@kipred.org apo: +381 38 542 778.

Botuar nga:



Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)

Rr. Major Mehmet Bushi, H.III. No.1

10 000 Prishtinë, Kosovë

Telefoni dhe faksi: +381 38 542 778

Përmbajtja:

Përmbledhje Ekzekutive	6
Profili i Komunës së Ferizajit.....	10
Profili i Komunës së Kaçanikut	18
Profili i Komunës së Hanit të Elezit	26
Profili i Komunës së Shtimes	32
Profili i Komunës së Shtërpces.....	38

Përmbledhje Ekzekutive

Qëllim i këtij profili të komunave të Rajonit të Ferizajit është që të përdoret si shtytje për hapjen e debatit publik, dhe t'i ndihmojë vendim-marrësit komunalë dhe kombëtarë në formulimin dhe zbatimin e politikave që do t'i adresojnë nevojat e popullatës rinore, gjegjësisht të grup-moshës 15-29 vjet.

Për këtë qëllim, KIPRED-i ka përmbledhur të dhënat për strukturën e popullatës dhe lëvizjet demografike, për nivelin dhe strukturën e arsimit, të kulturës dhe sportit, shtrirjen e teknologjisë informative, strukturën religjioze, përfshirë këtu edhe numrin e objekteve dhe të klerikëve fetarë, ekstremizmin e dhunshëm, nivelin e kriminalitetit, strukturën e popullatës sipas aktivitetit ekonomik, buxhetet komunale dhe mbështetjen që ato e ofrojnë për aktivitetet rinore, për Komunat e Ferizajit, të Hanit të Elezit, Kaçanikut, Shtimes dhe Shtërpces.

Të dhënat tregojnë se shumica absolute e popullatës së grup-moshës (15-29 vjet) të komunave të këtij rajoni jetojnë në pjesët rurale të këtyre komunave. Nivelin më të lartë të arsimit e kanë Komuna e Ferizajit dhe ajo e Shtërpces, ndërsa më të ulët in e kanë Komuna e Shtimes dhe ajo e Hanit të Elezit. Infrastruktura kulturore dhe sportive për të rinjtë në këto komuna është tejet e varfër, dhe ajo nuk i plotëson as për së afërmi nevojat e kësaj grup-moshe të popullatës.

Për sa i përket strukturës religjioze, shumica absolute e banorëve në këto komuna (98%>), pos asaj të Shtërpces, janë deklaruar që i përkasin besimit islam. Në Komunën e Ferizajit, raporti xhami për banorë në fshatra është 0.7 xhami në 1000 banorë, ndërsa në qytet është 0.15 xhami në 1000 banorë, në Komunën e Kaçanikut ky raport është 0.65 xhami në 1000 banorë në fshatra, dhe 0.3 xhami në 1000 banorë në qytet, në Komunën e Shtimes, 0.7 xhami në 1000 banorë në fshatra, dhe 0.15 xhami në 1000 banorë në qytet, ndërkaq, në komunat rurale të Hanit të Elezit dhe të Shtërpces (për banorët e deklaruar të besimit islam) 1 dhe 0.75 xhami në 1000 banorë respektivisht.

Numri i individëve që iu janë bashkangjitur luftërave të huaja, domethënë, organizatave terroriste në Irak dhe Siri, për Komunën e Hanit të Elezit është 1 në 1000 banorë, ku 0% e tyre

kanë të kaluar kriminale, për Komunën e Kaçanikut është 0.94 individë në 1000 banorë, me 80% me të kaluar kriminale, për Komunën e Ferizajit është 0.17 individë në 1000 banorë, me 50% me të kaluar kriminale, për Komunën e Shtimes ky raport është 0.07 në 1000 banorë, me 50% me të kaluar kriminale, dhe në Komunën e Shtërpces nuk ka patur individë që iu janë bashkangjitur luftrave të huaja. Në përgjithësi, gjendja ekonomike e këtyre individëve është e dobët dhe mesatare, dhe ata kanë shkollim të mesëm dhe të lartë.

Numri i veprave penale për 1000 banorë është më i larti në Komunën e Shtërpces dhe të Ferizajit me 19.3 dhe 19 respektivisht. Ky numër në Komunën e Kaçanikut është 13.5, dhe në atë të Shtimes 11.00, ndërkaq më i ulëti është në Komunën e Hanit të Elezit me 6.1 vepra penale për 1000 banorë.

Në Komunën e Ferizajit 3.40% e popullatës janë në gjendje të rëndë ekonomike, duke jetuar nga ndihmat sociale, ndërsa 5.50% si burim kryesor të jetesës i kanë pensionet, në Komunën e Kaçanikut 5.00% e popullatës jetojnë nga ndihmat sociale, dhe 5.00% nga pensionet, në Komunën e Hanit të Elezit 5.00% e popullatës jetojnë nga ndihmat sociale, dhe 6.00% nga pensionet, në Komunën e Shtimes 5.90% e popullatës jetojnë nga ndihmat sociale, dhe 6.00% nga pensionet, ndërkaq, gjendja më e rëndë është në Komunën e Shtërpces, ku 8.40% e popullatës jetojnë nga ndihmat sociale, dhe 9.50% nga pensionet.

Për sa i përket shpenzimeve kapitale dhe subvencioneve për kulture, sport dhe rini, në Komunën e Ferizajit këto paraqesin 5.70% të vlerës së përgjithshme të shpenzimeve kapitale, në atë të Kaçanikut 4.50%, në Hanin e Elezit 0.00%, në Shtime 3.35%, dhe në Shtërpce 0.00%. Këto shpenzime as për së afërmi nuk i plotësojnë nevojat për aktivitetet jashtëshkollore për të rinjtë e këtyre komunave, të cilët kanë në disponim një infrastrukturë tejet të varfër, apo edhe inekzistente komunale në fushën e sportit, kulturës dhe të aktiviteteve të tjera ekstra-kurrikulare.

Në fund, në tabelën e mëposhtme është dhënë një pasqyrë e përmbledhur e të dhënave socio-ekonomike të komunave të rajonit të Ferizajit.



	Ferizaji	Kacaniku	Hani i Elezit	Shtime	Shtërpce
Popullata	102517	34409	10009	27324	6949
Grup-mosha 15-29	27%	27%	26.40%	27.10%	23.85%
Qyteti	40%	31.10%	*	26%	15.10%
Fshati	60%	68.90%	100%	74%	84.90%
Niveli i Arsimit					
Analfabetë (në 1000 banorë)	38	36	39	50	28
Pa shkollim fillor (në 1000 banorë)	95	85	92	125	91
Shkolla fillore (në 1000 banorë)	490	523	577	546	516
Shkolla e mesme (në 1000 banorë)	350	338	290	281	314
Studimet e larta (në 1000 banorë)	65	53	39	46	75
Institucione shkollore fillore dhe të mesme	61	27	7	21	6
Religjioni					
Xhamitë	49	18	10	15	5
Klerikë Islam	50	21	13	15	5
Kisha Katolike	1	0	0	0	0
Klerikë Katolikë	1	0	0	0	0
Kisha protestante	0	0	0	0	0
Klerikë protestantë	2	2	2	0	0
Kisha ortodokse	6	0	0	1	16
Luftëtarë të Huaj Terroristë	18	32	10	2	0
Mosha mesatare	31.7	33.6	36.8	27.5	*
Niveli i Arsimit	Mesëm	Mesëm/Lartë	*	Lartë	*
Gjendja ekonomike	Mesatare/Dobët	Mesatare/Dobët	Dobët/Mesatare	Dobët/Mesatare	*
Prapavija kriminale	50%	80%	0%	50%	*
Kriminaliteti (vepra penale/në 1000 banorë)	19	13.5	6.1	11	19.3
Gjendja ekonomike					
Popullata ekonomikisht aktive	42%	35.30%	37.60%	36%	47.40%
Të punësuar	56%	50.50%	46.80%	47%	40%
Me ndihma sociale	3.40%	5%	5%	5.90%	8.40%
Të varur nga pensioni	5.50%	5%	6%	6%	9.50%
Buxheti komunal (EUR)	29.2 milion	7.7 milion	2.8 milion	6.8 milion	3.7 milion
Shpenzimet kapitale dhe subvencionet	32%	21.45%	36.20%	25%	30.10%
Shpenzimet kapitale dhe subvencionet për rini	5.70%	4.50%	0%	3%	0%

Profili i Komunës së Ferizajit

Fakte dhe shifra

- **Struktura e popullatës dhe lëvizjet demografike**

Për nga popullsia, Ferizaji është komuna e tretë në nivel të Kosovës. Të dhënat e regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 tregojnë që kjo komunë ka patur 108 mijë banorë, ndërkohë që deri në vitin 2017 kjo shifer ka rënë për 6000 banorë, domethënë, në 102 mijë.¹ Sipas përkatësisë etnike, 96% të banorëve të Ferizajit janë shqiptarë, 3% ashkali, dhe 1% i përkasin grupeve të tjera etnike. Raporti gjinor i popullatës është 50.5% meshkuj dhe 49.5% femra.



Kjo analizë është e përqëndruar në të rinjtë, dhe atë në grupmoshën 15-29 vjet, dhe këta e paraqesin 27% të popullsisë së përgjithshme, domethënë, në raport me grupmoshat 0-14 (29%), së bashku me 30-80 (44%)². Regjistrimi i popullsisë tregon që numri më i madh i të rinjëve në Komunën e Ferizajit (60%) jeton në 43 fshatrat e komunës, ndërkaj, pjesa tjetër prej 40% jeton në qytet. Një zbërthim i lëvizjeve demografike të kësaj grupmoshe tregon se ka një lëvizje të vazhdueshme të të rinjëve nga fshati në qytet.³

¹ Popullsia e Kosovës dhe shtimi natyror për vitin 2017, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

² Popullsia sipas përkatësisë etnike 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

³ Popullsia sipas moshave dhe llojit të vendbanimit, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

- **Niveli dhe struktura e arsimit, kulturës dhe sportit.**

Të dhënat për popullatën mbi 10 vjet, sipas nivelit të arsimit dhe njohjes së lexim-shkrimit tregojnë se në 1000 banorë, 38 janë analfabetë, 95 nuk e kanë përfunduar asnjë nivel të shkollimit, 490 kanë përfunduar vetëm shkollën fillore, 350 kanë përfunduar shkollën e mesme, dhe 65 i kanë përfunduar studimet universitare dhe post-universitare.⁴

Komuna e Ferizajit ka gjithsej 61 institucione arsimore fillore dhe të mesme me 1559 mësimdhënës, me një raport të shkollave prej 1.4 për 1000 banorë deri në moshën 19-vjeçare⁵. Këtu duhet theksuar se që të gjitha (8) shkollat e mesme në këtë komunë janë të lokuara vetëm në qytet. Në korrik të vitit 2015, në Komunën e Ferizajit është themeluar Universiteti i Shkencave të Aplikuara⁶, në të cilin studiojnë 1419 studentë⁷. Në këtë qytet janë hapur edhe kampuse të kolegjeve private, dhe atë ai i Kolegjit AAB⁸, Kolegjit Universum⁹ dhe i Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT)¹⁰, për numrin e studentëve të të cilave nuk ka të dhëna të sortuara në domenin publik.

Në komunën e Ferizajit janë 13 klube sportive, 5 biblioteka dhe teatri profesional që nga viti 1943¹¹. Fatkeqësisht, shuma e investimeve kapitale nuk mjafton që të rinjtë e angazhuar në këto fusha t'i plotësojnë nevojat e tyre për t'i ushtruar aktivitetet e tyre të lira.

⁴ Popullsia e moshës 10 vjeçe e mbi sipas nivelit të arsimit (2011), Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

⁵ Statistikat e Arsimit në Kosovë 2017/2018, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Linku: <http://ask.rks-gov.net/media/4145/stat-e-arsimit-2017-2018-shqip.pdf>.

⁶ Universiteti i Shkencave të Aplikuara, <http://www.ushaf.net/>.

⁷ Statistikat e Arsimit në Kosovë 2017/2018, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Linku: <http://ask.rks-gov.net/media/4145/stat-e-arsimit-2017-2018-shqip.pdf>.

⁸ Kolegji AAB në Ferizaj, <https://aab-edu.net/ferizaj/>.

⁹ Kampusi i Kolegjit Universum, <http://universum-ks.org/kontakt/>.

¹⁰ Universiteti për Biznes dhe Teknologji, <https://www.ubt-uni.net/sq/ballina/>.

¹¹ Në mungesë të përgjigjës ndaj kërkesës së KIPRED-it drejtuar Komunës së Ferizajit më 31 korrik 2018, këto të dhëna janë marrë nga https://sq.wikipedia.org/wiki/Komuna_e_Ferizajt.

- **Teknologjia Informative**

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për shtrirjen e Internetit, shihet që në vitin 2011 qasje në Internet kanë patur 60% e popullsisë, ku përqindjet përkatëse për qytet dhe për fshatra ishin 72% dhe 52%¹². Këto shifra nuk e pasqyrojnë gjendjen e sotme, ku kjo shtrirje me siguri se ka patur zgjerim të madh falë sistemeve Wi-Fi dhe platformave të telefonisë mobile.

- **Struktura religjioze**

Në aspektin e përkatësisë religjioze, 98.6% e popullatës së Komunës së Ferizajit janë deklaruar të besimit islam, ndërkaq, nga pjesa tjetër, të besimit katolik janë deklaruar 0.38%, të besimit ortodoks 0.04%, dhe 0.59% të të tjerëve përfshijnë personat pa përkatësi fetare, si dhe ata që kanë preferuar të mos përgjigjen.¹³

Në territorin e Komunës së Ferizajit janë funksionale 49 xhami, gjashtë prej të cilave janë në qytet dhe 43 ndodhen në fshatra. Numri i klerikëve islam është 50.¹⁴ Këtu duhet theksuar që vetëm në tre vitet e fundit, në territorin e kësaj komune në shërbim të besimtarëve islam janë vënë 11 xhami të reja¹⁵. Raporti xhami për banorë në fshatra është 0.7 xhami për 1000 banorë, ndërkaq, në qytet 0.15 xhami për 1000 banorë. Në këtë komunë veprojnë edhe tri shoqata nën autoritetin e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), ku një është humanitare, një e të rinjëve, dhe një e grave¹⁶. Besimtarët katolikë në shërbim të tyre e kanë një kishë katolike dhe një klerik të lpushkvisë së Kosovës, besimtarët protestantë i kanë dy klerikë, mirëpo nuk e kanë asnjë kishë protestante¹⁷, dhe besimtarët ortodoksë i kanë 6 kisha ortodokse¹⁸.

¹² Penetrimi i Internetit te Ekonomitë Familjare (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e statistikave të Kosovës.

¹³ Popullsia sipas gjinisë, religjionit dhe komunës 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave te Kosoves

¹⁴ Të dhëna nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018

¹⁵ Organisation for Security and Cooperation in Europe, Ferizaj/Urosevac Municipal Profile (2015), <https://www.osce.org/kosovo/13132?download=true>

¹⁶ Të dhëna nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018

¹⁷ Të dhëna nga lpushkvia e Kosovës, 19 korrik 2018, dhe Bashkësia e Kishës Protestante të Kosovës, 20 korrik 2018.

- **Ekstremizmi i dhunshëm**

Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, grupeve terroriste në Siri dhe Irak iu janë bashkangjitur 18 individë nga komuna e Ferizajit, përkatësisht 0.17 individë për 1000 banorë. Të dhënat për prapavijën personale të këtyre individëve tregojnë se 50% e tyre kanë patur të kaluar kriminale, pastaj, se kanë nivel të mesëm të shkollimit, dhe se janë në një gjendje ekonomike mesatare ose të dobët. Moshë mesatare e këtyre individëve është 31.7 vjet.¹⁹

Edhe përkundrejt këtij numri mjaft të lartë të individëve nga komuna e Ferizajit që u janë bashkangjitur grupeve terroriste në Lindjen e Mesme, duhet të theksohet se Kuvendi Komunal i Ferizajit nuk ka evidencë publike që dëshmon se deri më tash është mbajtur edhe mbledhje të vetme për ta trajtuar këtë problem të sigurisë²⁰.

Nga ana tjetër, në një bisedë me anëtarë të Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës të ngarkuar me monitorimin e Planit të Veprimit të Strategjisë për Parandalimin e Radikalizmit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm, udhëheqësia e Komunës së Ferizajit e ka ngritur shqetësimin se në këtë komunë veprojnë edhe disa Organizata Jo-Qeveritare (OJQ) me karakter fetar, që në veprimtaritë e tyre nga të rinjtë kërkojnë më shumë shërbesa fetare sesa zhvillim të aktivitete rinore.²¹ Ndërlidhja e këtyre OJQ-ve me radikalizmin fetar mbetet e paqartë, mirëpo kërkesa e shërbesave fetare jashtë kornizës së Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK) në Ferizaj, është arsye për një shqetësim të lartë sa i përket sigurisë në komunë.

¹⁸ Organisation for Security and Cooperation in Europe, Municipal Profile of Ferizaj/Urosevac (2015) <https://www.osce.org/kosovo/13132?download=true>.

¹⁹ Të dhëna nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Policia e Kosovës, 27 korrik, 2018.

²⁰ Shih proces-verbalet e Kuvendit Komunal të Ferizajit nga viti 2013, <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/category/procesverbalet/>.


²¹ Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, Raport mbi zbatimin e Strategjisë për parandalim e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm në nivelin lokal (Vizita në komuna), Maj 2018.

- **Niveli i kriminalitetit**

Statistikat për nivelin e kriminalitetit në Komunën e Ferizajit tregojnë që brenda vitit të kaluar (2017) në këtë Komunë janë kryer 1947 vepra penale,²² domethënë, 19 vepra penale për 1000 banorë, shifër kjo që e pasqyron një nivel të lartë të kriminalitetit. Pjesa më e madhe e veprave penale hyjnë në kategoritë e veprave kundër pasurisë (1158), dhe të veprave kundër jetës dhe trupit (551).²³

- **Struktura e popullatës sipas aktivitetit ekonomik**

Të dhënat statistikore (2011) për Komunën e Ferizajit tregojnë se nga 77 mijë persona të moshës mbi 15 vjet, vetëm 42.4% janë ekonomikisht aktivë – dhe vetëm 56% e tyre janë të punësuar. Ekonomikisht joaktivë janë deklaruar 57.6% e popullsisë mbi 15 vjet.²⁴ Struktura e pjesës së punësuar të popullatës sipas shkollimit, për grup-moshën 15-29 vjet është paraqitur në grafikun e mëposhtëm.



Sa i përket qytetarëve që nuk janë ekonomikisht aktiv, 33% e tyre si arsye për këtë e deklarojnë vijimin e shkollimit, ndërsa 48% deklarohen që kujdesen për familjen apo shtëpinë. Këtu duhet

²² Të dhëna nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Policia e Kosovës, 3 gusht 2018.



²³ Ibid.

²⁴ Popullsia e moshës 15 vjeç e mbi sipas statusit të aktivitetit aktual (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

të ceket se 3.4% e popullatës janë në gjendje ekonomike të rëndë, duke jetuar nga ndihmat sociale, ndërkaq, 5.5% si burim kryesor të jetesës i kanë pensionet.²⁵

- **Buxheti Komunal dhe mbështetja për aktivitetet rinore.**

Për nga buxheti total Komuna e Ferizajit rangohet si komuna e tretë në Kosovë, pas Prishtinës dhe Prizrenit, dhe për vitin fiskal 2018, ky buxhet e kap shumën prej 29.2 milion Eurosh. Të hyrat në buxhet janë kryesisht nga dhënie të qeveritare që përbëjnë rreth 84% të totalit të tij, ndërkaq, rreth 16% të pjesës së mbetur Komuna i gjeneron nga të hyrat vetanake. Pagat dhe mëditjet mbesin kategori që e përbën rreth 52% të buxhetit total. Kategoria e mallrave dhe shërbimeve bën pjesë me rreth 12%, ndërkaq, pjesa që i dedikohet investimeve kapitale është mbi 32% e shumës totale.²⁶




Nëse buxhetin e analizojmë në raport me investimet kapitale dhe përkrahjen e kulturës, rinisë dhe sportit, më në veçanti me infrastrukturën dhe aktivitetet që ndërlidhen me rini, shihet që buxheti nuk e përfaqëson në asnjë mënyrë këtë grup të popullatës (grup-mosha 15-29 vjet), që e paraqet 27% të popullatës së Komunës së Ferizajit.

²⁵ Popullsia sipas burimit kryesor të jetesës (2011), Platforma Online ASKDTA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

²⁶ Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, Ministria e Financave, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/668E7D87-490C-4229-881B-E66CE614F4C1.pdf>.

Në buxhetin e vitit 2018, vetëm 1.87% (547,000 Euro) e buxhetit total parashihet të shpenzohet ashtu që të ketë impakt tek të rinjtë, dhe kjo është e kategorizuar në tërësi në kuadrin e shpenzimeve kapitale, duke e paraqitur 5.7% të këtyre shpenzimeve.²⁷ Për më tutje, 69% e kësaj shume është e dedikuar për subvencione dhe transfere, ndërsa 31% për shpenzime kapitale.





²⁷Ibid.

Profili i Komunës së Kaçanikut

Fakte dhe shifra

- **Struktura e popullatës dhe lëvizjet demografike**

Për nga numri i banorëve, Kaçaniku është një nga komunat e vogla në nivel të Kosovës. Të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 tregojnë që Komuna e Kaçanikut ka pasur 33 mijë banorë, dhe deri në vitin 2017 kjo shifër është rritur edhe për 1000 banorë, që don të thotë që sot janë 34 mijë.²⁸ Sipas përkatësisë etnike, pothuaj 100% e banorëve të Kaçanikut janë shqiptarë. Raporti gjinor i popullsisë së Kaçanikut është 50.8% meshkuj dhe 49.2% femra.



Kjo analizë është e përqendruar në të rinjtë, dhe atë në grupmoshën 15-29 vjet, të cilët e paraqesin 27% të popullsisë së përgjithshme, pra, në raport me grupmoshat 0-14 vjet (28.6%), dhe 30-80 vjet (44.4%)²⁹. Regjistrimi i popullsisë tregon që numri më i madh i të rinjëve (68.9%) të Komunës së Kaçanikut jetojnë në 31 fshatrat e komunës, ndërkaq, 31.1% e tyre jetojnë në qytet. Një zbrëthim i lëvizjeve demografike të kësaj grupmoshe tregon se është një lëvizje e vazhdueshme e të rinjëve nga fshati në qytet.³⁰

²⁸ Popullsia e Kosovës dhe shtimi natyror për vitin 2017, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

²⁹ Popullsia sipas përkatësisë etnike 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

³⁰ Popullsia sipas moshave dhe llojit të vendbanimit, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

- **Niveli dhe struktura e arsimit, kulturës dhe sportit.**

Të dhënat për popullatën mbi 10 vjet të komunës së Kaçanikut, sipas nivelit të arsimit dhe njohjes së lexim-shkrimit, tregojnë se në 1000 banorë, 36 janë analfabetë, 85 nuk e kanë përfunduar asnjë nivel të shkollimit, 523 kanë përfunduar vetëm shkollën fillore, 338 kanë përfunduar shkollën e mesme, dhe 53 i kanë përfunduar studimet universitare dhe post-universitare.³¹

Komuna e Kaçanikut ka gjithsej 27 institucione arsimore fillore dhe të mesme me 466 mësimdhënës, ku numri i shkollave për 1000 banorë të moshës deri në 19 vjet është 2.08.³² Këtu duhet theksuar që të gjitha shkollat e mesme në këtë komunë (dy sosh) ndodhen vetëm në qytet. Komuna e Kaçanikut ka 11 klube sportive, 10 biblioteka, dy shtëpi të kulturës, tri shoqata kulturore, dhe dy stadione jashtë objekteve shkollore.³³

- **Teknologjia Informative**

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për shtrirjen e Internetit, shihet që në vitin 2011 në komunën e Kaçanikut 44.16% e popullsisë kanë pasur qasje në Internet, dhe kjo shtrirje e qasjes ishte 53% për qytet dhe 40% në fshatra.³⁴ Këto shifra nuk e pasqyrojnë gjendjen e sotme, ku kjo shtrirje me siguri se ka patur zgjerim të madh falë sistemeve Wi-Fi dhe platformave të telefonisë mobile.

³¹ Popullsia e moshës 10 vjeçe e mbi sipas nivelit të arsimit (2011), Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

³² Statistikat e Arsimit në Kosovë 2017/2018, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Linku: <http://ask.rks-gov.net/media/4145/stat-e-arsimit-2017-2018-shqip.pdf>.

³³ Të dhëna nga Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës së Komunës së Kaçanikut, 31 korrik 2018.

³⁴ Penetrimi i Internetit te Ekonomitë Familjare (2011) , Platforma Online ASKDATA, Agjencia e statistikave të Kosovës.

- **Struktura religjioze**

Në aspektin e përkatësisë religjioze, 99.9% e popullatës së komunës së Kaçanikut janë deklaruar të besimit islam.³⁵ Në territorin e komunës janë funksionale 18 xhami, gjashtë nga të cilat (3) janë në qytet dhe 15 të tjera ndodhen nëpër fshatra, ndërkaq, numri i klerikëve islamë është 21.³⁶ Këtu duhet theksuar që gjatë tre viteve të fundit në territorin e kësaj komune kanë hyrë në shërbim të besimtarëve islamë edhe tri xhami të reja.³⁷ Raporti xhami për banorë, në fshatrat e Kaçanikut është 0.65 xhami në 1000 banorë, dhe 0.3 xhami në 1000 banorë në qytet. Në këtë komunë veprojnë edhe tri shoqata nën autoritetin e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), ku njëra është humanitare, një e të rinjëve, dhe një e grave.³⁸ Besimtarët e paktë protestantë në këtë komunë në shërbim të tyre i kanë dy klerikë, mirëpo ata nuk e kanë asnjë kishë protestante.³⁹

- **Ekstremizmi i dhunshëm**

Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, grupeve terroriste në Siri dhe Irak iu janë bashkangjitur 32 individë nga komuna e Kaçanikut, domethënë, 0.94 individë për 1000 banorë. Të dhënat për prapavijën personale të këtyre individëve tregojnë se 80% e tyre kanë pasur të kaluar kriminale, pastaj, që kanë nivel të mesëm dhe të lartë të shkollimit, dhe se janë në një gjendje ekonomike mesatare ose të dobët. Mosha mesatare e këtyre individëve është 33.6 vjet⁴⁰, ndërkaq, personi i fundit prej tyre që iu është bashkangjitur grupeve terroriste, këtë e ka bërë në vitin 2013.⁴¹ Për më tepër, shumica e këtyre individëve nuk kanë kurfarë përkrahje dhe mbështetje nga familjet e tyre.⁴²

³⁵ Popullsia sipas gjinisë, religjionit dhe komunës 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

³⁶ Të dhëna nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018.

³⁷ Organisation for Security and Cooperation in Europe, Kaçanik Municipal Profile (2015), <https://www.osce.org/kosovo/13116?download=true>.

³⁸ Të dhëna nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018.

³⁹ Të dhëna nga Ipeshkvia e Kosovës, 19 korrik 2018, dhe Bashkësia e Kishës Protestante të Kosovës, 20 korrik 2018.

⁴⁰ Të dhëna nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Policia e Kosovës, 27 korrik, 2018.

⁴¹ Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, Raport mbi zbatimin e Strategjisë për parandalim e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm në nivelin lokal (Vizita në komuna), Maj 2018.

⁴² Ibid.

Këtu duhet theksuar se nuk ka evidencë publike që Kuvendi Komunal i Komunës së Kaçanikut nuk e ka mbajtur asnjë mbledhje për të vlerësuar këtë problem të sigurisë.⁴³ Sidoqoftë, udhëheqësia komunale mendon se në këtë komunë është mbajtur një numër i madh i debateve, hulumtimeve dhe konferencave, dhe se ato nuk kanë sjellur ndonjë ndihmesë të veçantë.⁴⁴ Nga ana tjetër, sipas burimeve policore, në Komunën e Kaçanikut janë mbyllur të gjitha shoqatat e dyshimta, dhe nuk ka objekte fetare të besimit islam që janë jashtë autoritetit të BIK-ut.⁴⁵

- **Niveli i kriminalitetit**

Statistikat për nivelin e kriminalitetit për komunën e Kaçanikut tregojnë se brenda vitit të kaluar (2017) në këtë komunë janë kryer 462 veprave penale,⁴⁶ domethënë, 13.5 vepra penale për 1000 banorë, shifër kjo që e tregon një nivel të lartë të kriminalitetit. Pjesa më e madhe e veprave penale të kryera hyjnë në kategorinë e veprave kundër pasurisë (290) dhe të atyre kundër jetës dhe trupit (117).⁴⁷

- **Struktura e popullatës sipas aktivitetit ekonomik**

Të dhënat statistikore (2011) për Komunën e Kaçanikut tregojnë se nga rreth 24 mijë persona të moshës mbi 15 vjet, vetëm 35.3% janë ekonomikisht aktivë - dhe vetëm 50.5% e tyre janë të punësuar. Ekonomikisht joaktivë janë deklaruar 64.7% e popullsisë mbi 15 vjet.⁴⁸ Struktura e pjesës së punësuar të popullatës sipas shkollimit, për grup-moshën 15-29 vjet është paraqitur në grafikun e mëposhtëm.

⁴³ Shih proces-verbalet e Kuvendit Komunal të Kaçanikut, <https://kk.rks-gov.net/kacanik/category/procesverbalet/>


⁴⁴ Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, Raport mbi zbatimin e Strategjisë për parandalim e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm në nivelin lokal (Vizita në komuna), Maj 2018.

⁴⁵ Ibid.

⁴⁶ Të dhëna nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Policia e Kosovës, 3 gusht 2018.

⁴⁷ Ibid.

⁴⁸ Popullsia e moshës 15 vjeç e mbi sipas statusit të aktivitetit aktual (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.



Sa i përket qytetarëve që nuk janë ekonomikisht aktiv, 30% e tyre si arsye për këtë e deklarojnë vijimin e shkollimit, ndërkaq, 54% deklarojnë që janë duke u kujdesur për familjen apo shtëpinë. Këtu duhet të ceket se 5% e popullatës janë në gjendje ekonomike të rëndë, duke jetuar nga ndihmat sociale, ndërkaq, 5.0% si burim kryesor të jetesës i kanë pensionet.⁴⁹



- **Buxheti Komunal dhe mbështetja për aktivitetet rinore.**

Për vitin fiskal 2018, Komuna e Kaçanikut e ka një buxhet prej rreth 7.7 milion Eurosh.⁵⁰ Të hyrat në buxhet janë kryesisht nga dhëniet qeveritare, të cilat përbëjnë rreth 89% të totalit të tij, ndërkaq, rreth 11% të pjesës tjetër të buxhetit gjenerohet nga të hyrat vetanake. Pagat dhe mëditjet janë kategori që e përbën rreth 65% të buxhetit total. Kategoria e mallrave dhe shërbimeve bën pjesë me 9.1% të buxhetit, ndërkaq, pjesa që i dedikohet investimeve kapitale është 21.45% e shumës totale.⁵¹

⁴⁹ Popullsia sipas burimit kryesor të jetesës (2011), Platforma Online ASKDTA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.


⁵⁰ Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, Ministria e Financave, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/668E7D87-490C-4229-881B-E66CE614F4C1.pdf>.

⁵¹ Ibid.



Nëse buxhetin e analizojmë në raport me investimet kapitale dhe përkrahjen e kulturës, rinisë dhe sportit, më në veçanti me infrastrukturën dhe aktivitetet që ndërlidhen me rini, shihet që buxheti nuk e përfaqëson në asnjë mënyrë këtë grup të popullatës (grup-mosha 15-29 vjet), që e paraqet 27% të popullatës së Komunës së Kaçanikut.

Në buxhetin e vitit 2018, vetëm 1.0% (77,000 Euro) e buxhetit total parashihet të shpenzohet ashtu që të ketë impakt tek të rinjtë, dhe kjo është e kategorizuar në tërësi si pjesë e investimeve kapitale, duke e paraqitur 4.5% e të këtyre investimeve.⁵²



⁵² Të dhëna nga Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës së Komunës së Kaçanikut, 31 korrik 2018.

Gjatë këtij viti Komuna e Kaçanikut i ka subvencionuar shtatë klube, dy aktivitete sportive dhe tri shoqata kulturore, me 47 mijë Euro për aktivitete kulturore dhe sportive, si dhe me 30 mijë Euro për investime kapitale në sport dhe kulturë.⁵³


⁵³ Të dhëna nga Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës së Komunës së Kaçanikut, 31 korrik 2018.

Profili i Komunës së Hanit të Elezit

Fakte dhe shifra

- **Struktura e popullatës dhe lëvizjet demografike**

Për nga numri i banorëve dhe popullata, Hani i Elezit është një komunë e vogël dhe rurale në nivel të Kosovës. Të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 tregojnë që Komuna e Hanit të Elezit ka pasur 9,403 banorë, dhe deri në vitin 2017 kjo shifër është rritur për 606 veta, që don të thotë që sot Hani i Elezit i ka 10,009 banorë.⁵⁴ Sipas përkatësisë etnike, pothuaj 99.5% të banorëve të Hanit të Elezit janë shqiptarë, ndërkaq, 0.5% janë boshnjakë. Raporti gjinor i popullatës është 51.5% meshkuj dhe 48.5 femra.



Kjo analizë është e përqendruar në të rinjtë, dhe atë në grupmoshën 15-29 vjet, dhe këta e paraqesin 26.4% të popullsisë së përgjithshme, pra, në raport me grupmoshat 0-14 vjet (29.5%), dhe 30-80 vjet (44.1%)⁵⁵. Këta banorë jetojnë në 10 fshatrat e Komunës së Hanit të Elezit.

⁵⁴ Popullsia e Kosovës dhe shtimi natyror për vitin 2017, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

⁵⁵ Popullsia sipas përkatësisë etnike 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

- **Niveli dhe struktura e arsimit, kulturës dhe sportit.**

Sipas nivelit të arsimit dhe njohjes së lexim-shkrimit, të dhënat për popullatën mbi 10 vjet tregojnë se në 1000 banorë të Hanit të Elezit, 39 janë analfabetë, 92 nuk kanë përfunduar asnjë nivel të shkollimit, 577 kanë përfunduar vetëm shkollën fillore, 290 kanë përfunduar shkollën e mesme, dhe 39 i kanë të përfunduara studimet universitare dhe post-universitare.⁵⁶

Komuna e Hanit të Elezit ka gjithsej shtatë institucione arsimore fillore dhe të mesme me 102 mësimdhënës, ku raporti i shkollave për 1000 banorë të moshës deri në 19 vjet është 1.9.⁵⁷

Komuna e Hanit të Elezit ka tre klube sportive, një bibliotekë dhe një shtëpi të kulturës, dhe një shoqatë kulturore, një sallë të sporteve dhe një fushë sporti që është jashtë funksionit.⁵⁸

- **Teknologjia Informative**

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për shtrirjen e Internetit shihet që në vitin 2011, qasje në Internet kanë patur 43.66% e popullsisë.⁵⁹ Kjo shifër nuk e pasqyron gjendjen e sotme, ku shtrirja e qasjes në Internet me siguri se ka patur zgjerim të madh falë sistemeve Wi-Fi dhe platformave të telefonisë mobile.

- **Struktura religjioze**

Në aspektin e përkatësisë religjioze, pothuaj 100% e banorëve të Komunës së Hanit të Elezit janë deklaruar të besimit islam.⁶⁰ Në territorin e komunës janë funksionale 10 xhami, dy prej të cilave janë në qendrën komunale dhe tetë të tjera ndodhen nëpër fshatra. Numri i klerikëve islam është trembëdhjetë.⁶¹ Gjatë tre viteve të fundit, në shërbim të besimtarëve islamë në

⁵⁶ Popullsia e moshës 10 vjeçe e mbi sipas nivelit të arsimimit (2011), Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

⁵⁷ Statistikat e Arsimit në Kosovë 2017/2018, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Linku: <http://ask.rks-gov.net/media/4145/stat-e-arsimit-2017-2018-shqip.pdf>.

⁵⁸ Të dhëna nga Drejtoria për Kulturë dhe Arsim e Komunës së Hanit të Elezit, 12 korrik 2018.

⁵⁹ Penetrimi i Internetit te Ekonomitë Familjare (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e statistikave të Kosovës.

⁶⁰ Popullsia sipas gjinisë, religjionit dhe komunës 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

⁶¹ Të dhëna nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018.

territorin e komunës së Hanit të Elezit kanë hyrë edhe 2 xhami të reja.⁶² Raporti xhami për banorë në fshatra është 1 xhami në 1000 banorë. Në këtë komunë veprojnë edhe tre shoqata nën autoritetin e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), ku njëra është humanitare, një e të rinjëve, dhe një e grave.⁶³ Në këtë komunë është edhe një numër i vogël i besimtarëve protestantë, dhe këta në shërbim të tyre i kanë dy klerikë, mirëpo nuk e kanë asnjë kishë protestante.⁶⁴

- **Ekstremizmi i dhunshëm**

Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, grupeve terroriste në Siri dhe Irak iu janë bashkangjitur 10 individë nga komuna e Hanit të Elezit, që don të thotë 1 individ për 1000 banorë. Të dhënat për prapavijën personale të këtyre individëve tregojnë se ata nuk kanë pasur të kaluar kriminale, dhe se kanë qenë në një gjendje ekonomike të dobët ose mesatare. Mosha mesatare e këtyre individëve është 36.8 vjet.⁶⁵

Këtu duhet theksuar se nuk ka evidence publike që dëshmonë që Kuvendi Komunal i Komunës së Hanit të Elezit ka mbajtur mbledhje për ta vlerësuar këtë problem të sigurisë⁶⁶. Po ashtu, duhet përmendur që me vendim të Ministrisë së Administratës Publike të Kosovës për shkak të veprimtarive të paligjshme është mbyllur një OJQ me karakter fetar – Shoqata Kulturore “Nektari”, e cila ka vepruar në këtë komunë⁶⁷.

⁶² Organisation for Security and Cooperation in Europe, Hani i Elezit Municipal Profile (2015), <https://www.osce.org/kosovo/31420?download=true>.

⁶³ Të dhëna nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018.

⁶⁴ Të dhëna nga Ipeshkvia e Kosovës, 19 korrik 2018, dhe Bashkësia e Kishës Protestante të Kosovës, 20 korrik 2018.

⁶⁵ Të dhëna nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Policia e Kosovës, 27 korrik, 2018.

⁶⁶ Shih proces-verbalet e Kuvendit Komunal të Hanit të Elezit, <https://kk.rks-gov.net/haniielezit/category/procesverbalet/>


⁶⁷ Të dhëna nga Departamenti për OJQ, Ministria e Administratës Publike të Kosovës, 13 gusht, 2018.

- **Niveli i kriminalitetit**

Statistikat për nivelin e kriminalitetit në Komunën e Hanit të Elezit tregojnë që brenda vitit të kaluar (2017), në këtë komunë janë kryer 61 vepra penale,⁶⁸ domethënë 6.1 vepra penale për 1000 banorë. Pjesa më e madhe e këtyre veprave penale bëjnë pjesë në kategorinë e veprave kundër pasurisë (24) dhe kundër jetës dhe trupit (19).⁶⁹

- **Struktura e popullatës sipas aktivitetit ekonomik**

Të dhënat statistikore (2011) për Komunën e Hanit të Elezit tregojnë se nga rreth 6625 persona që janë të moshës mbi 15 vjet, vetëm 37.6% janë ekonomikisht aktivë – prej të cilëve vetëm 46.8% janë të punësuar. Ekonomikisht joaktivë janë deklaruar 62.4% e popullsisë mbi 15 vjet.⁷⁰ Struktura e popullatës së punësuar sipas shkollimit për grup-moshën 15-29 vjet është paraqitur në grafikun e mëposhtëm.



Sa i përket qytetarëve që nuk janë ekonomikisht aktiv, 23.6% e tyre si arsye e deklarojnë vijimin e shkollimit, ndërkaq, 59.5% deklarojnë që kujdesen për familjen apo shtëpinë. Këtu duhet të

⁶⁸ Të dhëna nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Policia e Kosovës, 3 gusht 2018.



⁶⁹ Ibid.

⁷⁰ Popullsia e moshës 15 vjeç e mbi sipas statusit të aktivitetit aktual (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

ceket se 5.0% e popullatës janë në gjendje të rëndë ekonomike, duke jetuar nga ndihmat sociale, ndërkaq, 6.0% si burim kryesor të jetesës i kanë pensionet.⁷¹

- **Buxheti Komunal dhe mbështetja për aktivitetet rinore.**

Për vitin fiskal 2018, Komuna e Hanit të Elezit ka buxhet prej rreth 2.8 milion Eurosh.⁷² Të hyrat në buxhet janë kryesisht nga dhënit qeveritare, të cilat përbëjnë rreth 89% të totalit të tij, ndërkaq, pjesën e mbetur prej rreth 11% të buxhetit Komuna e gjeneron nga të hyrat vetanake. Pagat dhe mëditjet janë kategori që përbën rreth 52.2% të buxhetit total. Kategoria e mallrave dhe shërbimeve bën pjesë me 8.14% të buxhetit total, ndërkaq, pjesa që u dedikohet investimeve kapitale është 36.2% e shumës totale.⁷³



Në këtë vit Komuna e Hanit të Elezit i ka subvencionuar aktivitetet sportive me vlerë prej 10 mijë Eurosh, ndërkaq, kjo nuk ka ndarë buxhet për investime kapitale në sport dhe kulturë.⁷⁴ Nëse e analizojmë buxhetin në raport me investimet kapitale dhe për përkrahjen e kulturës, rinisë dhe sportit, më në veçanti, në infrastrukturën dhe aktivitetet që ndërlidhen me rini, shihet që buxheti në asnjë mënyrë nuk e përfaqëson këtë grup (grup-mosha 15-29 vjet), i cili e paraqet 26.4% të popullatës së tërësishme të Komunës së Hanit të Elezit.

⁷¹ Popullsia sipas burimit kryesor të jetesës (2011), Platforma Online ASKDTA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

⁷² Buxheti i Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2018, <https://kk.rks-gov.net/hanielezit/wp-content/uploads/sites/37/2018/01/KOMUNA-HANI-I-ELEZIT-BUXHETI-2018.pdf>.

⁷³ Ibid.



⁷⁴ Të dhëna nga Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës së Komunës së Hanit të Elezit, 12 korrik 2018.

Profili i Komunës së Shtimes

Fakte dhe shifra

- **Struktura e popullatës dhe lëvizjet demografike**

Për nga numri i banorëve, Shtimja është një nga komunat e vogla në nivel të Kosovës. Të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 tregojnë që Komuna e Shtimes ka pasur 27,324 banorë, ndërkaq, deri në vitin 2017 kësaj shifre i janë shtuar edhe 540 veta, duke e bërë numrin e banorëve 27,864 mijë.⁷⁵ Sipas përkatësisë etnike, 96.8% të banorëve të Shtimes janë shqiptarë, 2.7% ashkalinj, dhe të tjerët u përkasin grupeve të tjera etnike. Raporti gjinor i popullatës është 50.7% meshkuj dhe 49.3% femra.



Kjo analizë është e përqendruar në të rinjtë, dhe atë në grupmoshën 15-29 vjet, të cilët e paraqesin 27.1% të popullsisë së përgjithshme, pra, në raport me grupmoshat 0-14 vjet (31.5%) dhe 30-80+ vjet (41.5%)⁷⁶. Regjistrimi i popullsisë tregon që numri më i madh i të rinjëve (74%) në komunën e Shtimes jeton në 22 fshatrat e komunës, ndërsa 26% e tyre jeton në qytet. Një zbrërthim i lëvizjeve demografike të kësaj grupmoshe tregon se është një lëvizje e vazhdueshme e të rinjëve nga fshati në qytet.⁷⁷

⁷⁵ Popullsia e Kosovës dhe shtimi natyror për vitin 2017, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

⁷⁶ Popullsia sipas përkatësisë etnike 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

⁷⁷ Popullsia sipas moshave dhe llojit të vendbanimit, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

- **Niveli dhe struktura e arsimit, kulturës dhe sportit.**

Të dhënat për popullatën mbi 10 vjet të komunës së Shtimes, sipas nivelit të arsimit dhe njohjes së lexim-shkrimit, tregojnë se në 1000 banorë, 50 janë analfabetë, 125 nuk e kanë përfunduar asnjë nivel të shkollimit, 546 kanë përfunduar vetëm shkollën fillore, 281 kanë përfunduar shkollën e mesme, dhe 46 i kanë të përfunduara studimet universitare dhe post-universitare.⁷⁸

Komuna e Shtimes ka gjithsej 21 institucione arsimore fillore dhe të mesme, me 424 mësimdhënës, ku numri i shkollave për 1000 banorë të moshës deri në 19 vjet është 1.73.⁷⁹ Në komunën e Shtimes janë tri klube dhe shoqata sportive funksionale, pesë shoqata kulturore, një bibliotekë dhe një shtëpi të kulturës.⁸⁰

- **Teknologjia Informativ**

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për shtrirjen e Internetit, shihet që në vitin 2011 në komunën e Shtimes 46.5% e popullsisë ka pasur qasje në Internet, dhe kjo shtrirje e qasjes ishte 56.1% për qytet dhe 42.7% në fshatra⁸¹. Këto shifra nuk e pasqyrojnë gjendjen e sotme, ku kjo shtrirje me siguri se ka patur zgjerim të madh falë sistemeve Wi-Fi dhe platformave të telefonisë mobile.

- **Struktura religjioze**

Në aspektin e përkatësisë religjioze, 99.6% e popullatës së komunës së Shtimes janë deklaruar të besimit islam, ndërkaq, nga pjesa tjetër, 0.2% janë deklaruar të besimit ortodoks, dhe rreth 0.2% i paraqesin personat pa përkatësi fetare, si dhe ata që kanë preferuar të mos përgjigjen.⁸²

⁷⁸ Popullsia e moshës 10 vjeçe e mbi sipas nivelit të arsimimit (2011), Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

⁷⁹ Statistikat e Arsimit në Kosove 2017/2018, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Linku: <http://ask.rks-gov.net/media/4145/stat-e-arsimit-2017-2018-shqip.pdf>.

⁸⁰ Këto të dhëna janë marrë nga, https://sq.wikipedia.org/wiki/Shtimja_në_mungesë_të_përgjigjes_ndaj_kërkesës_së_KIPRED-it_drejtuar_Komunës_së_Shtimës_më_11_korrik_2018.

⁸¹ Penetrimi i Internetit të Ekonomitë Familjare (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e statistikave të Kosovës.

⁸² Popullsia sipas gjinisë, religjionit dhe komunës 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Në territorin e komunës së Shtimes janë funksionale 15 xhami, dy nga të cilat janë në qytet dhe 13 të tjerat ndodhen nëpër fshatra, ndërkaq, numri i klerikëve islamë është 15.⁸³ Këtu duhet theksuar që gjatë tre viteve të fundit, në territorin e kësaj komune, në shërbim të besimtarëve islamë ka hyrë edhe një xhami e re⁸⁴. Raporti xhami për banorë, në fshatrat e Shtimes është 0.7 xhami në 1000 banorë, dhe 0.15 xhami në 1000 banorë në qytet. Në këtë komunë veprojnë edhe tri shoqata nën autoritetin e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), ku njëra është humanitare, një është e të rinjëve, dhe një e grave.⁸⁵ Po ashtu, besimtarët ortodoksë të Shtimes në shërbim të tyre e kanë një kishë ortodokse⁸⁶.

- **Ekstremizmi i dhunshëm**

Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, grupeve terroriste në Siri dhe Irak iu janë bashkangjitur 2 individë nga komuna e Shtimes, që don të thotë 0.07 individë për 1000 banorë. Të dhënat për prapavijën personale të këtyre individëve tregojnë se që të gjithë, pra 100% e tyre, kanë pasur të kaluar kriminale, që kanë nivel të lartë të shkollimit, dhe se janë në një gjendje ekonomike mesatare ose të dobët. Moshë mesatare e këtyre individëve është 27.5 vjet.⁸⁷ Këtu duhet theksuar se nuk ka evidence publike që Kuvendi Komunal i Komunës së Shtimes ka mbajtur mbledhje për ta trajtuar këtë problem të sigurisë.⁸⁸

- **Niveli i kriminalitetit**

Statistikat për nivelin e kriminalitetit për komunën e Shtimes tregojnë se brenda vitit të kaluar (2017) në këtë komunë janë kryer 302 vepra penale,⁸⁹ domethënë, 11 vepra penale për 1000 banorë. Pjesa më e madhe e këtyre veprave penale bëjnë pjesë në kategorinë e veprave kundër pasurisë (166) dhe të atyre kundër jetës dhe trupit (80).⁹⁰

⁸³ Të dhëna nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018.

⁸⁴ Organisation for Security and Cooperation in Europe, Stimlje Municipal Profile (2015), <https://www.osce.org/kosovo/13129?download=true>.

⁸⁵ Të dhëna nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018.

⁸⁶ Organisation for Security and Cooperation in Europe, Municipal Profile of Ferizaj/Urosevac (2015) <https://www.osce.org/kosovo/13129?download=true>.

⁸⁷ Të dhëna nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Policia e Kosovës, 27 korrik, 2018.


⁸⁸ Shih process-verbalet e Kuvendit Komunal të Shtimes, <https://kk.rks-gov.net/shtime/category/procesverbalet/>

⁸⁹ Të dhëna nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Policia e Kosovës, 3 gusht 2018.

⁹⁰ Ibid.

- **Struktura e popullatës në bazë të aktivitetit ekonomik**

Të dhënat statistikore (2011) për Komunën e Shtimes tregojnë se nga rreth 18,743 persona të moshës mbi 15 vjet, vetëm 36% janë ekonomikisht aktivë – dhe vetëm 47% e tyre janë të punësuar. Ekonomikisht joaktivë janë deklaruar 64% e popullsisë mbi 15 vjet.⁹¹ Struktura e pjesës së punësuar të popullatës sipas shkollimit, për grup-moshën 15-29 vjet është paraqitur në grafikun e mëposhtëm.





Sa i përket qytetarëve që nuk janë ekonomikisht aktiv, 32% e tyre si arsye për këtë e deklarojnë vijimin e shkollimit, ndërkaq, 49.7% deklarojnë që janë duke u kujdesur për familjen apo shtëpinë. Këtu duhet të ceket se 5.9% e popullatës janë në gjendje ekonomike të rëndë, duke jetuar nga ndihmat sociale, ndërkaq, 6% si burim kryesor të jetesës i kanë pensionet.⁹²

⁹¹ Popullsia e moshës 15 vjeç e mbi sipas statusit të aktivitetit aktual (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

⁹² Popullsia sipas burimit kryesor të jetesës (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.


- **Buxheti Komunal dhe mbështetja për aktivitetet rinore.**

Për vitin fiskal 2018, Komuna e Shtimes e ka një buxhet prej rreth 6.8 milion Eurosh. Të hyrat në buxhet janë kryesisht nga dhëniet qeveritare, të cilat përbëjnë rreth 93.7% të totalit të tij, ndërkaq, rreth 6.3% të pjesës tjetër të buxhetit Komuna i gjeneron nga të hyrat vetanake. Pagat dhe mëditjet janë kategori që e përbën rreth 60.6% të buxhetit total. Kategoria e mallrave dhe shërbimeve bën pjesë me 10.2% të buxhetit, ndërkaq, pjesa që i dedikohet investimeve kapitale është 25% e shumës totale.⁹³



Nëse buxhetin e analizojmë në raport me investimet kapitale dhe përkrahjen e kulturës, rinisë dhe sportit, më në veçanti me infrastrukturën dhe aktivitetet që ndërlidhen me rini, shihet që buxheti nuk e përfaqëson në asnjë mënyrë këtë grup të popullatës (grup-mosha 15-29 vjet), që e paraqet 27.1% të popullatës së Komunës së Shtimes.

⁹³ Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, Ministria e Financave, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/668E7D87-490C-4229-881B-E66CE614F4C1.pdf>



Për vitin 2018, vetëm 0.8% e buxhetit total të Komunës së Shtimes parashihet të shpenzohet ashtu që të ketë impakt tek të rinjtë, dhe kjo është e kategorizuar në tërësi si pjesë e investimeve kapitale, duke e paraqitur 3.35% e të këtyre investimeve.⁹⁴ Këtu, 47% e kësaj shume është e dedikuar për subvencione dhe transfere, ndërsa 53% për shpenzime kapitale.



⁹⁴ibid.

Profili i Komunës së Shtërpces

Fakte dhe shifra

- **Struktura e popullatës dhe lëvizjet demografike**

Për nga numri i banorëve, Shtërpca është komunë e vogël në nivel të Kosovës. Të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 tregojnë që Komuna e Shtërpces ka pasur 6949 banorë, ndërkaq, deri në vitin 2017 kjo shifër është zvogëluar për 153 veta, kështu që kjo komunë tash i ka 6793 banorë.⁹⁵ Sipas përkatësisë etnike, 54% të banorëve të Shtërpces janë shqiptarë, dhe 45% e tyre janë serbë, ndërkaq, komunitetet e tjera e përbëjnë 1% të popullatës. Raporti gjinor i popullatës së Shtërpces është 51.5% meshkuj dhe 48.5% femra.



Kjo analizë është e përqendruar në të rinjtë, dhe atë në grupmoshën 15-29 vjet, të cilët e paraqesin 23.8% të popullsisë së përgjithshme, pra, në raport me grupmoshat 0-14 vjet (25.5%) dhe 30-80+ vjet (50.6%)⁹⁶. Regjistrimi i popullsisë tregon që numri më i madh i të rinjëve (84.9%) në Komunën e Shtërpces jeton në 16 fshatrat e komunës, ndërsa pjesa tjetër prej

⁹⁵ Popullsia e Kosovës dhe shtimi natyror për vitin 2017, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

⁹⁶ Popullsia sipas përkatësisë etnike 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

15.1% të tyre jeton në qytet. Një zbrëthim i lëvizjeve demografike të kësaj grupmoshe tregon se është një lëvizje e vazhdueshme e të rinjëve nga fshati në qytet.⁹⁷

- **Niveli dhe struktura e arsimit, kulturës dhe sportit.**

Të dhënat për popullatën mbi 10 vjet të komunës së Shtërpces, sipas nivelit të arsimit dhe njohjes së lexim-shkrimit tregojnë se në 1000 banorë, 28 janë analfabetë, 91 nuk e kanë përfunduar asnjë nivel të shkollimit, 516 kanë përfunduar vetëm shkollën fillore, 314 kanë përfunduar shkollën e mesme, dhe 75 i kanë të përfunduara studimet universitare dhe post-universitare.⁹⁸

Komuna e Shtërpces ka gjithsej 6 institucione arsimore fillore dhe të mesme me 90 mësimdhënës, ku numri i shkollave për 1000 banorë të moshës deri në 19 vjet është 1.75.⁹⁹ Këtu duhet theksuar që shkolla e mesme e vetme në këtë komunë (dy sosh) ndodhet në qytet.

- **Teknologjia Informativë**

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për shtrirjen e Internetit, shihet që në vitin 2011 në komunën e Shtërpces 30.63% e popullsisë ka pasur qasje në Internet, dhe kjo shtrirje e qasjes ishte 43.98% për qytet dhe 26.66% në fshatra.¹⁰⁰ Këto shifra nuk e pasqyrojnë gjendjen e sotme, ku kjo shtrirje me siguri se ka patur zgjerim të madh falë sistemeve Wi-Fi dhe platformave të telefonisë mobile.

- **Struktura religjioze**

Në aspektin e përkatësisë religjioze, 54.3% e popullatës së Komunës së Shtërpces janë deklaruar të besimit islam, ndërkaq, 45.3% janë deklaruar të besimit ortodoks.¹⁰¹ Në territorin e komunës janë funksionale 16 kisha ortodokse, ndërsa komuniteti musliman i ka në shërbim të

⁹⁷ Popullsia sipas moshave dhe llojit të vendbanimit, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

⁹⁸ Popullsia e moshës 10 vjeçe e mbi sipas nivelit të arsimit (2011), Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

⁹⁹ Statistikat e Arsimit në Kosovë 2017/2018, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Linku: <http://ask.rks-gov.net/media/4145/stat-e-arsimit-2017-2018-shqip.pdf>.

¹⁰⁰ Penetrimi i Internetit të Ekonomitë Familjare (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e statistikave të Kosovës.

¹⁰¹ Popullsia sipas gjinisë, religjionit dhe komunës 2011, Platforma Online ASK Data, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

vetin pesë xhami të cilat ndodhen nëpër fshatra, ku numri i klerikëve islamë është pesë.^{102 103} Raporti xhami për banorë, për komunitetin mysliman, në fshatrat e komunës është 0.75 xhami në 1000 banorë. Në këtë komunë veprojnë edhe tri shoqata nën autoritetin e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), ku njëra është humanitare, një është e të rinjëve, dhe një e grave.¹⁰⁴

- **Ekstremizmi i dhunshëm**

Në Komunën e Shtërpces nuk është shënuar asnjë rast i bashkangjijtes së qytetarëve të kësaj komune grupeve terroriste në Lindjen e Mesme.

- **Niveli i kriminalitetit**

Statistikat për nivelin e kriminalitetit në Komunën e Shtërpces tregojnë se në këtë komunë brenda vitit të kaluar (2017) janë kryer 131 vepra penale,¹⁰⁵ që don të thotë, 19.3 vepra penale për 1000 banorë, dhe kjo e paraqet një nivel të lartë të kriminalitetit. Pjesa më e madhe e veprave penale hyjnë në kategorinë e veprave kundër pasurisë (58) dhe të atyre kundër jetës dhe trupit (48).¹⁰⁶

- **Struktura e popullatës në bazë të aktivitetit ekonomik**

Të dhënat statistikore (2011) për Komunën e Shtërpces tregojnë se nga rreth 5178 persona të moshës mbi 15 vjet, vetëm 47.4% janë ekonomikisht aktivë – dhe vetëm 40% e tyre janë të punësuar. Ekonomikisht joaktivë janë deklaruar 52.6% e popullsisë mbi 15 vjet.¹⁰⁷

Struktura e pjesës së punësuar të popullatës sipas shkollimit, për grup-moshën 15-29 vjet është paraqitur në grafikun e mëposhtëm.

¹⁰² Të dhëna nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018.


¹⁰³ Organisation for Security and Cooperation in Europe, Shtërpce Municipal Profile (2015), <https://www.osce.org/kosovo/13130?download=true>.

¹⁰⁴ Të dhëna nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), 7 korrik, 2018.

¹⁰⁵ Të dhëna nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Policia e Kosovës, 3 gusht 2018.

¹⁰⁶ Ibid.

¹⁰⁷ Popullsia e moshës 15 vjeç e mbi sipas statusit të aktivitetit aktual (2011), Platforma Online ASKDATA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.



Sa i përket qytetarëve që nuk janë ekonomisht aktiv, 24.7% e tyre si arsye për këtë e deklarojnë vijimin e shkollimit, ndërkaq, 42.4% deklarojnë që janë duke u kujdesur për familjen apo shtëpinë. Këtu duhet të ceket se 8.4% e popullatës janë në gjendje ekonomike të rëndë, duke jetuar nga ndihmat sociale, ndërkaq, 9.5% si burim kryesor të jetesës i kanë pensionet.¹⁰⁸



- **Buxheti Komunal dhe mbështetja për aktivitetet rinore.**

Për vitin fiskal 2018, Komuna e Shtërpces e ka një buxhet prej rreth 3.7 milion Eurosh.¹⁰⁹ Të hyrat në buxhet janë kryesisht nga dhënit qeveritare, të cilat përbëjnë rreth 92% të totalit të tij, ndërkaq, rreth 8% të pjesës tjetër të buxhetit Komuna i gjeneron nga të hyrat vetanake. Pagat dhe mëditjet janë kategori që e përbën rreth 56.7% të buxhetit total. Kategoria e mallrave dhe shërbimeve bën pjesë me 11.2% të buxhetit, ndërkaq, pjesa që i dedikohet investimeve kapitale është 30.1% e shumës totale.¹¹⁰

¹⁰⁸ Popullsia sipas burimit kryesor të jetesës (2011), Platforma Online ASKDTA, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

¹⁰⁹ Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, Ministria e Financave, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/668E7D87-490C-4229-881B-E66CE614F4C1.pdf>

¹¹⁰ Ibid.



Nëse buxhetin e analizojmë në raport me investimet kapitale dhe përkrahjen e kulturës, rinisë dhe sportit, më në veçanti me infrastrukturën dhe aktivitetet që ndërlidhen me rini, shihet që buxheti nuk e përfaqëson në asnjë mënyrë këtë grup të popullatës (grup-mosha 15-29 vjet), që e paraqet 23.8% të popullatës së Komunës së Shtërpces.

Consortium: "With Participatory Democracy for a Kosovo without Radicalization" | Konzorciumi: "Me Demokraci Pjesëmarrëse për një Kosovë pa Radikalizim"

